



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-14816 dt. 22/03/ 2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **29.03.2024**, (E Premte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më dt. 29.02.2024.
2. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për vazhdimin e afatit të zbatimit të Planit për vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, 2021-2023, deri në hartimin e Planit të Ri të vlerësimit të Rrezikshmërisë.
6. Raporti përfundimtar për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.
7. Raport i Planit të Biznesit 2024 të NPL “Stacioni i Autobusëve” SHA-Drenas.
8. Të ndryshme.

Drenas, 22.03.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 06064 / 12500 dt. 19/03 / 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 29.02.2024
e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari
Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). *Mungoi: Malsore Cakiqi*
Të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-s zyra e informimit, sekretari organizativ i Qendrës të LVV Nëntor Zeka.

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Znj. Kosovare Halilaj Karaxha, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Albulena Saliuku e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të kuvendit Komunal i mbajtur më dt. 29.01.2024.
3. Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 02-353/01-5031 dt.29.01.2024 për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.
4. Propozim vendim për subvencionimin e nënave lehona.
5. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtareve të komisionit komunal aksionar për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A
6. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 29.02.2024, ku për diskutim ishin 6 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: njoftoi se kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës: Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të

paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite), në mbledhjen e kaluar e kam tërheq nga rendi i ditës jo për arsye se i kam pas apo jo votat por për arsye se Bekim Lestrani e ka ngrit një shqetësim të një familjes të dëshmoreve, dhe unë e kam shiku dokumentin e kam analizu dhe as nuk ka qenë ajo pronë e parapamë për listë fillestare dhe as nuk është në listë fillestare. Lista fillestare është një procedurë që Kuvendi duhet me miratim me i hap rrugë investimeve të brendshme dhe të jashtme, pa miratim paraprak ne nuk mund me i dhënë pronë askujt me negocim në rastet kur prona nuk ka qenë në listën paraprake tri vitet e fundit, prandaj ju ftoj që ta votoni.

Egzona Tërdevci: në emër të grupit të LVV ne jemi kundër që kjo pikë të përfshihet në rendin e ditës, ka mundur të shtohet në mbledhjen e KPF-së ka mundur të diskutohet po ja ka ardhë kështu pa na informuar, po ashtu në pronat që janë në listë janë dy probleme është parcela 13.0 në Glllobar, kam kërkuar sqarime tek Drejtoria e Infrastrukturës për projektin e Kamenicës në pisha, në atë parcelë është duke u ndërtuar parkingu i komunës nuk e di cili është kuptimi për me dhënë një parcelë në shfrytëzim nëse është duke u ndërtua një parking nga komuna për parkun e Kamenicës që është duke u ndërtuar në pisha. Si dhe është prona e komunës të vjetër përkatësisht shtëpia e kulturës për këtë pronë kam dërguar një kërkesë në Ministrinë e Kulturës tek departamenti i ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe ajo pronë është ende në vlerësim dhe nuk e di si mund te jepet në shfrytëzim një parcelë kur ende nuk është dhënë vendimi final nga komisioni vlerësues për këtë pronë, duke u nisur nga këto argumente dhe që nuk e keni pas në mbledhje te KPF-së dhe as nuk ka ndonjë urgjencë për trajtim në emër të LVV ne kundërshtojmë që kjo pikë të hyn në rend të ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: sa i përket pronës në Glllobar është në listën paraprake nuk ka të bëjë a kemi me dhënë pronën në tersi, investimet e rritin vlerën e pronës. Sa i përket shtëpisë se kulturës, asnjë vlerë kulturore, arkeologjike nuk e ka salla e kulturës, a është në fazën e vlerësimit apo jo pak rëndësi ka, jemi në listë paraprake nuk e dina a kemi me i leshu te gjitha në shfrytëzim a ka me pas dikush interes për ato prona dhe a ka me pas interes për gjithë pronën pra edhe një herë duhet me ardh për ta bërë ndarjen .

Egzona Tërdevci: në vitin 2022 kam kërkuar qasje ne dokumente publike me paskan dërguar informata të gabuara kërkoj falje publike që kam fol duke u bazuar në ato, sipas te dhënave objekti është ndërtuar në vitin 1954 që i bie më shumë se 45 vjet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: asnjë informacion te gabuar nuk e ke prej komunës.

Labinot Halilaj: unë jam kundër që të hyj si pikë e rendit të ditës, meqë nuk u diskutua as në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe sjellja e kësaj pike tepër të rëndësishme në mënyrë klandestine unë personalisht jam kundër dhe i ftoj të gjithë që ta mos votojnë.

Marigona Bazaj: edhe ne si grup i DD jemi kundër dhënies ne shfrytëzim te pronave komunale prandaj ne jemi kundër që kjo pikë të hyj rend dite.

Bekim Lestrani: lista e ngushtë për dhënien ne shfrytëzim të pronave komunale është publike që disa muaj në ueb faqen zyrtare të komunës, lista prej 70 pronave nuk është e menduar mirë dhe nuk na është prezantuar asnjë gjë as një projekt a diçka pse është ne interes me u dhënë në shfrytëzim brenda vitit, unë jam kundër dhe i ftoj edhe te tjerët me votu diçka çka nuk din se çka po votojnë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne ueb faqen e komunës i ke të gjitha pronat e komunës janë në listë që e kemi për obligim me e dergu para vitit tri, kjo listë është e njëjta sikurse muajin e kaluar nuk kam ndryshu asgjë, e pata tërheq nga rendi i ditës për shkak se pasi që e ngrite shqetësimin tuaj për ta verifikuar mirëpo nuk kam ndryshu asgjë.

Bekim Lestrani: ne votojmë këtu vetëm në bazë të asaj që prezantohet, ne seancën e kaluar i kemi pas listat përpara.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, dokumenti që ka qenë në mbledhjen e kaluar nuk ka ndryshuar asgjë është i njëjti.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hodhi në votim për të hyrë në rend dite propozimin e Kryetarit *Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite):*

Prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar:

“Për” votuan 13 anëtar.

Kundër votuan 16

Abstenim 1, nuk u votua që kjo pikë të hyj në rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës të lartcekur, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, “Për” votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua rendi i ditës pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Znj. Kosovare Halilaj Karaxha, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Drenas, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës” duke zëvendësuar znj. Albulena Saliuku e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.**

Znj. Kosovare Halilaj Karaxha, dha betimin: betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej, me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Drenasit (Gllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.12.2023.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 02-353/01-5031 dt.29.01.2024 për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, “Për” votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: 4. Propozim vendim për subvencionimin e nënave lehona.

Florentina Elezi: pyeti pse nuk është në rend dite edhe subvencionimi e fëmijëve për çerdhe pse nuk është në këtë mbledhje, i falënderoj në emër të grupit të gjithë asamblenë që e kanë votuar paraprakisht këtë propozim vendim i cili është shumë i rëndësishëm për të gjitha nënat e reja të Komunës së Drenasit dhe do të jetë një mbështetje shumë e madhe.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: do ta sjellim gjatë ditëve në vazhdim. Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, “Për” votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: 5. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtareve të komisionit komunal aksionar për ndërmarrjen publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, “Për” votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. Të ndryshme.

Drin Halilaj: pati pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë, për zv.drejtor në QKMF në Drenas e kam të paqartë se në konkursin e rihapur tek kriteret për pranimin e zv.Drejtorit të QKMF-së sipas rregullores mbi organizimin e brendshëm të QKMF-së neni 3 paragrafi 21 thotë zv drejtori i QKMF-së zgjidhet konfrom ligjit të shërbimit civil të Republikës së Kosovës thotë që është e obligueshme që zv.drejtori i QKMF-së të jetë doktor specialist nga mjekësia familjare dhe të ketë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në mënyrat e menaxhimit a është shkelje e rregullores nëse zgjidhet zv.drejtori me një drejtim tjetër psh me ekonomik, kurse në konkursin e rishpallur nga ju sipas kriterëve lejohen edhe kriterë tjerë. Pyeti për drejtorinë e Kulturës poligoni në fshatin Polluzhë që është ndërtuar para 6 viteve qytetaret janë ankuar se është dëmtuar shumë a do të bëhet diçka lidhur me këtë poligon.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: kur një konkurs nuk ka aplikues jo vetëm në institucionin tonë po gjitha institucionet zbresim kriteret sepse nuk po aplikon askush edhe nuk u vendos ende se kush do të zgjidhet janë kriteret. Nuk ka shkelje të rregullores, nëse ka shkelje janë organet përgjegjëse gjykata na kthen nëse dikush ankon. Ndërsa sa i përket poligonit në Polluzhë nëse shqetësimet i ngitni ktu nuk ka ndonjë efekt juridik sepse ankesat apo kërkesat duhet me u protokollua në komunë pastaj në mundemi me i dhënë përgjigje, ne kemi për obligim ligjor për riparimin, mirëmbajtjen e objekteve që kemi investu, por duhet me e bë një kërkesë e shikojmë kur t’i kemi mundësit me i reparu do të shohim.

Egzona Tërdevci: e kam një shqetësim për palestrën sportive “Hysni Jetullahu” është në gjendje shumë të keqe kam marr shqetësim nga një sportisteje e ceku që gjatë lojës ka qenë flohtë për shkak të dëmtimit të dritareve si është mundësia për ta bërë një rinovim për atë palestër sportive. Po ashtu lidhur me konkursin e fundit të QKMF-së në raport me infermier kemi marrë disa shqetësime që disa infermier që janë me shkollë të mesme dhe që janë të licencuar po ndihen të përjashtuar nga konkursi kërkoj një sqarim për këtë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: për palestër sportive “Hysni Jetullahu” janë edhe shqetësime tonat, i bëjmë bashkë kërkesë ministrit dhe na ndihmon me e bere ngrohjen, ne jemi duke e bërë fizibilitetin për objektet publike, janë disa procedura mirëpo nuk kemi mjete, prej vitit 2019 nuk kemi pas investime te reja për infrastrukturë prej qeverise se Kosovës.

Drejtoresha e Shëndetësisë, Lumnije Krap: sa i përket çështjen se ngritur e kemi diskutuar sepse kemi pas shqetësime të shumta mirëpo para se me hap konkursin kemi kontaktuar me oden e infermiereve dhe kemi kërkuar sqarim oda e i ka licencu edhe infermieret me shkollë të mesme edhe ata me bachelor mirëpo ne sipas kërkesave që na nevojitet kemi kërkuar infermier me bachelor mirëpo kur do që kemi nevojë për infermier me shkollë të mesme kërkojmë infermier me shkollë të mesme dmth nuk kemi bërë ndonjë shkelje apo diskriminim.

Egzona Tërdevci: sa i përket palestrës sportive është vështirë me pas buxhetin e mjaftueshëm mirëpo unë kam biseduar me ministrin Çeku këtë shqetësim ia kam përcjell edhe atij edhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka vullnet për me i ndihmu në rinovim të kësaj salle .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: po presim investime edhe për komunën tonë.

Beqir Kiqina: pati një kërkesë të banoreve të fshatit Baicë për Drejtorinë e Infrastrukturës pas shumë kërkesave që kemi pas viteve të kaluara është marrë vendim dhe ka kalu gjitha fazat e prokorimit rruga “Sabit Leku” e cila është një arterie shumë e rëndësishme që lidh shumë lagje të caktume të Baicës dhe e lidh fshatin tonë me rrugën kryesore për në Skenderaj është në gjendje jo të mirë, pasi që ka kalu gjitha fazat kur mund të filloj realizimi i projektit.

Endrit Gllareva, Drejtor i Infrastrukturës: siç e ceke kontrata është lidh por prej 15 marsit besoj qe fillojnë punimet.

Mehedin Salihu: siç e dini ne i kemi zjarrfikësit me një ekip të përgatitjes jashtëzakonisht të lartë dhe e kemi një ankesë nga ana e tyre që nuk po i paguajnë vikendeve nuk ju paguhet puna e natës dhe orët gjatë festave dmth nuk ju paguhet siç e lejon ligji mirëpo ju paguhet ma pak. I përmendet infermieret me bachelor është viti i dytë që ligji ia lejon pagat që me bachelor të kenë tjetër koeficient tek ne vazhdohet të paguhet me koeficientin e vjetër kur pritët që këta infermier ta marrin pagën sipas koeficientit që ia lejon ligji i pagave.

Nexhmedin Gruga, Drejtor i shërbimeve publike dhe emergjente: për vitin 2024 pagesat e orëve shtesë e festave dhe orëve të natës ka planifikuar një buxhet jo i mjaftueshëm për gjithë vitin mirëpo do të filloj të bëhet pagesa e tyre ndërsa për vitin 2022 janë paguar të gjitha ndërsa për vitin 2023 janë në procedurë, ndërsa për vitin 2024 do të fillojmë me pagesat e tyre por jo për gjithë vitin në mungesë të buxhetit.

Lumnije Krap, Drejtoreshë e Shëndetësisë, i kemi adresuar kërkesat për ngritjen e koeficientit në Ministrinë e Financave tani besoj se janë duke shqyrtuar.

Bekim Lestrani: pyeti drejtorin e Infrastrukturës kërkoj që ta shikoj një urë në lagjen Xhyllani në fshatin Baicë se është duke e rrezikuar jetën e qytetareve, e kemi pas të planifikuar para dy viteve si projekt ku ka shkuar ai projekt, dhe kërkoj që drejtori i

infrastrukturës me ju përmbajt premtimeve elektorale të cilat janë ujët e pijes qysh vitin e parë të qeverisjes, ndriçimi qysh vitin e parë të qeverisjes, do të asfaltohen gjitha rrugët dhe rrugicat do të rregullohet ura në lagjen Xhylani, do të përfundojnë ujerat e zeza, kanë mbet vetëm 700 metra për ujerat e zeza ndërsa në çdo vit ndajmë buxhet për 2500 metra ku mbesin ato.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: ne fshatin Baicë ne i bëjmë investimet nuk i bëni ju.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:16 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 29.02.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

<https://www.youtube.com/watch?v=Qw95xoGB-vE>

Procesmbajtëse: .



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 030/01-12507 dt. 11/03/ 2024

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1, 12.2 pika a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 27.12.2023 për transferimin nga Komuna në Agjencinë pyjore të stafit të Pylltarisë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë **28.02.2024** të aprovoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emertimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e DBPZHR

Neni 1

Me këtë propozim vendim të behët plotësim ndryshimi i Statutit të Komunës së Drenasit sa i përket nenit 85 duke e riformuluar emërtimin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe duke modifikuar kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

Neni 2

Sipas Memorandumit të bashkëpunimit për transferimin nga Komuna në Agjencinë pyjore të stafit të Pylltarisë, të datës 27.12.2023 gjithashtu të formohet Komisioni i cili do të këtë për detyrë të bëj riformulimin e emertimit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe të modifikoj kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

Neni 3

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit .



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me datë 27.12.2023 Komuna e Drenasit ka lidhur Memorandum të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal për transferimin nga Komuna e Drenasit në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të Pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë, përgjegjësive të njësive komunale etj bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet e tjera si dhe mjetet tjera përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore. Andaj duke marrë parasysh Memorandumin e lartëcekur dhe faktin se stafi i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural tashmë ka kaluar në Agjencinë Pyjore të Kosovës përmes këtij dokumenti propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kometencave të veta Kuvendi i Komunës të aprovoj Propozimin Vendimin Për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit duke e riformuluar emërtimin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe si dhe të formohet Komisioni i cili do të këtë për detyrë modifikojë kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

ORIGINAL
01 400/01-62171
28/12/2023




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr./Br./No. 5055
Nr. Iq. D. C. N. 1+5
Data/Date/Date 05.12.2023

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/ Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/ Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit

REFERENCË:		424/2023			
PËR/ZA/TO:		Z. Mergim Neziraj – Shef i Kabinetit të Ministrit të MAPL			
CC:		Z. Ramiz Lladrovci – Kryetar i Komunës së Drenasit			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Arkivës së MBPZhR-së			
NGA/OD/FROM:		Flutur Mustafa Pllana – Shefe e Kabinetit të Ministrit të MBPZhR 			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Letër përcjellëse			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:		Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date:	04.12.2023

Të nderuar,

Ju lutem bashkëngjitur gjeni Memorandum Bashkëpunimin ndërmjet MBPZhR, MAPL dhe Komunës së Drenasit.

Me respekt,



Nr./Br./B:	5055
Nr. Iq/B:	5
Data/Date:	05.12.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Bazuar në të nenit 76 pika 7 e dispozitave kalimtare të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyjet (i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 9 me dt. 3 Prill 2023), Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, Rregullore (QRK)-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive palët e poshtë shënuar lidhin këtë:

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

Për transferimin nga komuna në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë, përgjegjësve të njësive komunale etj., bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet tjera, si dhe mjetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore.

Ky Memorandum i Bashkëpunimit lidhet ndërmjet:

MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
më tej e referuar si, MBPZHR

MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
më tej e referuar si, MAPL dhe

KOMUNËS SË DRENASIT
më tej e referuar si, Komuna e Drenasit

Neni 1

QËLLIMI

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përmbushja e objektivit të përgjithshëm kthimit të kompetencave në zbatimin të nenit 76 pikës 7 të Ligjit me nr. 08/L-137 për pyjet.

Neni 2

OBJEKTI

1. Objekt i këtij memorandumi bashkëpunimi është zbatimi i e normës juridike të nenit 76 pikës 7 të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyjet, për transferimin nga Komunat në Agjencinë Pyjore të Kosovës të rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë dhe përgjegjësve të njësive komunale, bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet tjera, si dhe mjetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme Pyjore.

Neni 3

OBLIGIMET E PALËVE

1. Agjencia Pyjore e Kosovës,

- 1.1 Bën Pranimin nga Komunat të stafit të sektorit të pylltarisë dokumentacionin përkatës (listës së stafit që transferohet me të dhënat përkatëse, dosjeve personale fizike dhe elektronike) të rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë dhe përgjegjësve të njësive komunale etj, automjetet dhe pajisjet tjera, si dhe mjetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme të sektorit pyjor;
- 1.2 Organizon shërbimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve në territorin e Komunës;
- 1.3 Kryen të gjitha obligimet dhe shërbimet tjera sipas ligjit.



Neni 5

DOKUMENTET PËRCJELLËSE

1. Pjesë përbërëse të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë:

- 1.1 Lista e stafit të zyrtarëve të Njesisë Komunale me të dhënat përkatëse, që transferohet në APK;
- 1.2 Regjistri i inventarit dhe të gjitha aseteve të Njesisë Komunale që transferohet në APK.
- 1.3 Pranim dorëzimi i dokumentacioneve përkatëse dhe aseteve bëhet nga anëtarët e komisioneve të përbashkëta të emëruara me vendim nga APK.

Neni 6

ZGJIDHJA E KONTESTEVE

1. Kontestet eventuale rreth dispozitave të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit do të zgjidhen me marrëveshjen e palëve kontraktuese, e nëse nuk mund të arrihet marrëveshja, kontestin do ta zgjedh Gjykata kompetente .

Neni 7

HYRJA NË FUQI

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e palëve.



2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

- 2.1** Monitoron procesin e zbatimit të memorandumit të Bashkëpunimit për transferim e kompetencave të përcaktuara me nenin 76 pikës 7 të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyjet, nga komuna tek MBPZHR - APK;
- 2.2** Merr pjesë në koordinimin e aktiviteteve të cilat do të realizohen në zbatimin e marrëveshjes gjatë procesit transferimit të kompetencave nga komuna në MBPZHR-APK.

3. Komuna e Drenasit

- 3.1** Përgatitë dhe dorëzon dosjet personale të stafit-personelit që transferohet nga Komuna tek APK konform dispozitave nga Rregullorja (MBP) Nr.01/2020 për Përmbytjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- 3.2** Deri me datë 15.12.2023 përgatitë dhe dorëzon listën e zyrtarëve të sektorit pyjor që transferohet në APK me të dhënat përkatëse si: Kodi buxhetor i Komunës, emri mbiemri i zyrtarit që transferohet, nr. i letërnjoftimit, datëlindja, të dhënat për pagën, pozita e punës, kodi, emërtimi i pozitës sipas ligjit të pagës, kodi në SP, klasa, koeficienti, shtesa në pagë- përvoja e punës si dhe shtesa tjera nëse eventualisht ka, si dhe të dhënat bankare (emri i bankës dhe nr. llogarisë).
- 3.3** Përgatit dokumentacionin për transferimin e automjeteve dhe pajisjet tjera si dhe mjetet përkatëse funksionale për transfer nga Komuna tek APK;
- 3.4** Përgatit dhe dorëzon raportet e regjistrimeve të të gjitha terreneve pyjore të Komunës deri më datë 31.12.2023.

Neni 4

AMANDAMENTET

- 1.** Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshohet apo plotësohet sipas një marrëveshjeje me shkrim midis palëve. Ndryshimet dhe plotësimet janë pjesë përbërse e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit.





PALËT NËNSHKRUESE:

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministri i MBPZHR

Faton PECI



Data: 06 12 2023



Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministri i MAPL


Elbert KRASNIQI



Data: 07 12 2023

Komuna e Drenasit

Kryetari i Komunës

Ramiz LLADROVCI


Data: 27 12 2023



Zyra postare :
Post Office: **DRENAS**
Postanski urad:


Nr. seriik :
Serial no.
Serijski br

204520231614162

DËFTESË PËR PRANIMIN E DËRGESËS/CERTIFICATE OF DISPATCH'S ON ADMISSION/POTVRDA O PRIJEMU POSILJKE

Dërgesa: Mail: Posiljka	Letrat	Nr. i pranimit: Reception No Prijemni br	5728460	Date: Date: Datum:	28/12/2023
Marrësi: Recipient: Primalac:					
Adresa e marrësit: Address of the recipient: Adresa primaoca:					
PRISHTINE , PRISHTINË - Prishtinë					
Shërbime të veçanta: Particular services: Posebne usluge:					
R					
Vlera/Value/Vrednost 0.00					
Vertetësimi e shënimave e vërtetion dërguesi:					
Kundërpagues/Counter payment/Otkupnina 0.00					

Pesha 67 Gr
Weight 67 Gr
Tezina €
Taksa postare 1.20 €
Post. Tax 1.20 €
Postarina



Vërejtje: Të ruhet në rast reklamacioni
Remars: Keep in case of advertising
Napomena: Da se sacuva u slicaju reklamacije

Nënshkrimi
Signature
Polpis
Behar Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 21-07/01 12.367 dt. 11/03/2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3,4 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi:

PROPOZIM VENDIM

Për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si në vijim:

z.Valon Bequku nga Bashkësia Islame në Drenas zëvendësohet me z.Eset Bajraktarin

Neni 2


Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të zëvendësuar është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

 **Kryetari i Komunës**

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Meqenëse nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Drenas, përmes kërkesës me numër të protokolit 02-070/01-6208, kanë propozuar z.Eset Bajraktarin që të përfaqësoj Këshillin e Bashkësisë Islame në KKSB , kërkojmë të miratoni këtë propozim vendim me kërkesë të vet Bashkësisë.

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogocit)
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-463/06-13058, Dt. 13.03.2024

Bazuar në dispozitat e nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008, nenit 6, 7 dhe 10 të Ligjit për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës “Gazeta zyrtare” e Republikës së Kosovës nr.06/L-092, nenit 24 dhe nenit 25 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5,7, dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, konkretisht Policisë së Kosovës me nr.01/0378 të dt. 01.03.2024, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Drenasit të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

I. Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit, Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e Nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.

-Propozimi është për zonën kadastrale në Komoran në pjesën e ngastrës kad. Nr. P-70314035-01987-0 vendi i quajtur Fusha Gjer, toke ndërtimore e Klasës 1, në sipërfaqe prej $S= 2075 \text{ m}^2$ e cila është në pronësi të Komunës së Drenasit/Glllogocit dhe objektit me leje ndërtimore 08 Nr. 351-1466 të datës 23.06.2010 gjithashtu pronë komunale.

II. Qëllimi për dhënien në shfrytëzim të kësaj pronë është: për ndërtimin e Nënstacionit lokal policor në Komoran.

III. Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi shfrytëzimi i pronës do të bëhet pa kompensim.

III. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas miratimit të këtij vendimi të bënë bartjen administrative për 25 vite të sipërfaqes prej 2075 m^2 dhe objektit në emër të shfrytëzuesit – Ministrisë së Punëve të Brendshme – Stacionit Policor dhe të bënë regjistrimin në RDPP.

IV. Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

V. Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës:

Ramiz Lladrovci



A r s y e t i m

Duke u bazuar në kërkesën nr.01/0378 të dt. 01.03.2024 nga Ministria e Punëve të Brendshme, konkretisht Policisë së Kosovës për marrje në shfrytëzim të parcelës në zonën kadastrale në Komoran, konkretisht ngastrës kad. Nr. P-70314035-01987-0 vendi i quajtur Fusha Gjer, e cila ju është drejtuar Kryetarit të Komunës së Drenasit për iniciimin e procedurave për të lëshuar në shfrytëzim afatgjatë për së paku 25 vite të sipërfaqen prej 2075 m² dhe objektin e ndërtuar në Komoran për nevojat e nënstacionit policor.

Duke u bazuar në kërkesat e shumta të qytetareve, gjithashtu frekuentimin dhe lëvizjen e madhe të mjeteve dhe njerëzve përgjatë autostradës Ibrahim Rugova, si dhe numrit të madh të popullsisë përgjatë Komoranit dhe fshatrave përreth, Policia e Kosovës ka bërë kërkesë për shfrytëzimin e kësaj parcele së bashku me objektin në të cilën do ti përmbushte nevojat e Policisë së Kosovës në ofrimin sa me të shpejt të sigurisë në Komoran dhe vendbanimeve përreth. Krijimi i një nënstacioni të ri lokal policor në Komoran do ta bënte komunën tonë me të sigurt dhe do të lehtësonte punën e Policisë së Kosovës në ofrimin e shërbimeve në çdo pjesë.

Pjesë përbërës e këtij propozim-vendimi janë:

- Kërkesa nr.01/0378 të dt. 01.03.2024 e Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës
- Certifikatat mbi të drejtat e pronës;
- Kopja e planit si dhe
- Skica se ku është objekti dhe parcela, në Zonën Kadastrale Komoran, të Komunës së Drenasit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
/Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /Ministry of Internal
Affairs

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska

Direkcija / General Police Directorate



01/0378 2
01.03.2024
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINE

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		z. Ramiz LLADROVCI Kryetar i Komunës së Drenasit			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Kolonel Gazmend HOXHA Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Kërkesë			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:		Lokacioni: Kucni: Extension:	Policia e Kosovës Policija Kosova	Data: Datum: Date:	01.03.2024
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☒
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☐
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☒
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☐
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					☐

I nderuar z.Lladrovci,

Ju drejtohem përmes kësaj shkrese me shpresën se do të gjejnë mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj në lidhje me dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.

Policia e Kosovës ka ngritur kapacitetet e saja të burimeve njerëzore dhe organizative përmes strukturës së re të aprovuar vitin e kaluar, si dhe për shkak të kërkesave të banorëve dhe komunitetit në fshatin Komoran - Komuna e Drenasit Policia e Kosovës ka marrë vendim për themelimin e nënstacionit lokal policor në Komoran, i cili do të veprojë në kuadër të stacionit policor në Drenas.

Për shkak se në këtë pjesë jetojnë dhe frekuentojnë një numër i madh i banorëve si dhe zhvillohen edhe aktivitete, biznese dhe veprimtari të shumta dhe të ndryshme, themelimi dhe funksionalizimi i këtij nënstacioni do të ndihmojë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha dukurive negative, do të rritë nivelin e sigurisë, si dhe do të ngritë cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Me qëllim të realizimit të vizionit dhe objektivave të PK-së, por edhe të Komunës së Drenasit, që ndërlidhen me fushën e sigurisë, rendit e ligjit dhe duke qene interes i përbashkët, që policia të jetë efikase në përmbushje të misionit të saj dhe për shkaqe të mungesës së hapësirës/objektit është e nevojshme hapja e këtij nënstacioni për vendosjen e personelit.

Andaj, me mirësjellje kërkojmë mbështetjen tuaj duke na dhënë në shfrytëzim afatgjatë së paku 25 vite dhe me mundësi vazhdimi pronën e paluajtshme parcelën nr. 01987-0 dhe objektin e vendosur në këtë parcelë.

Paraprakisht ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe përkrahjen tuaj.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314035-01987-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 07942-03-13024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 13.03.2024 - 15:35
Komuna / Opština / Municipality: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Komorin / Komorane / Kamran
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70314035-01987-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	2075	SIPAS KERKESE SE TERENIT 07/942/52838 ME DT. 03.09.2019	12.07.2022	13.07.2022

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Verdi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi i Postat Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FUSHA GJER-FUSH GJER		IBRAHIM RUGOVA	12.07.2022	13.07.2022

A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcel Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcel Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Tokë Ndërtimore/Gradëvinsko zemljište/Construction land	Trrall/Zemlšte/Land		2075

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GILLOGOC / GLOGOVAC / GILLOGOC /		FEHIMI DHE XHEVË LADROVCI	1/1		12.07.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Komoran

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70314035-01987-0	Parcelë / Parcela / Parcel	2075



Shkalla/Razmera/Scale: 1:512

Punoi/Obradio/Created: Safet Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 03:34:24



Situacioni i Parcelës 01987-0, zk.Komoran





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-14366 dt. 20/03/2024

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1.3 e Ligjit nr.04/L-012 Për Mbrojtje nga Zjarri, neni 37 pika 2, paragrafët 2.2 dhe 2.5, neni 44 pika 3 e Ligjit Nr. 04/L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Neni 1

Propozoj që Kuvendi i Komunës së Drenasit ta aprovojë vazhdimin e afatit të zbatimit të Planit për Vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, 2021-2023, deri në hartimin e Planit të Ri të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

Neni 2


Plani i ri i Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, do të bëhet nga Komisioni i caktuar me Vendim nga Kryetari i Komunës dhe i njëjti do të paraqitet para Kuvendit për miratim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 4

Ky Propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL.


KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Pas hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planeve Rregulluese Urbane dhe Hartës Zonale për Komunën e Drenasit, është shtruar nevoja edhe për shqyrtimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për territorin e Komunës së Drenasit, që të dhënat në këtë plan të jenë të njëjta si në planet e lartshënuara, sepse, ka pasur ndryshime në ndërtime, infrastrukturë përcjellëse (rrugë, trotuare, ujësjellës, kanalizim, ndriçim) e të tjera.

Një dokument i tillë u drejtohet me propozimin për miratimin e tij duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi, Kryetari i Komunës obligohet që së bashku me mendimin e tij të njëjtin ta dorëzojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr 052/01-12798 Dt. 12.03.20247



PËR: z. Milaim Hajdari, Kryetar i Asamblesë Komunale në Drenas
Nga: z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës



Lënda: Raporti përfundimtar për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatim të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (I zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose I pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit.
1 B1	Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori dhe kode ekonomike	Udhëzimi administrativ Nr. 19/2009 për planin kontabël, nenit 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike. Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 985,078€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë ekzekutuar nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe shujtat. Përkatesisht, për paga dhe mëditje, nga investimet kapitale ishin paguar 702,915€ ndërsa nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 282,163€. Po ashtu, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 145,101€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga komuna si rezultat i keq buxhetimit dhe gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve të shkaktuar nga vet komuna dhe kanë të bëjnë me pagesat	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridentinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Shpenzimet për kompensimin e pagave jubilarë, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe shujtat. Kompensimet e lartëcekura në sektorin e arsimit janë shkaktuar si rezultat i dy kontratave kolektive, kontratës kolektive për arsim të vitit 2017 dhe vitit 2021. Keto kontrata kolektive për arsim janë të lidhura në mes të MASHTI dhe SBASHK pa mbulesë buxhetore, nuk i ka alokuar buxhet MASHTI dhe MFPT për kompensimet për paga jubilarë, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe shujtat dhe si rrjedhojë e mungesës së buxhetit në sektorin e arsimit janë shkaktuar borxhet e cekura tek gjetjet. Keto borxhe për kompensimin e pagave jubilarë, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe shujtat,	Pjesërisht i zbatuar	

		ndaj furnitorëve të ndryshëm, përkatësisht: - Nga investimet kapitale ishin paguar 118,958 për mallra dhe shërbime ngase pagesat ishin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative (vlera e pajisjeve për njësi është nën 1,000) për stafin e komunës, pajisje mjekësore dhe inventar për shkollat; si dhe - Nga mallrat dhe shërbimet komuna ka paguar 26,143€ për investime kapitale ngase pagesat ishin për pajisje vlera për njësi e të cilave ishte mbi 1,000 Keq klasifikimet e shpenzimeve të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishin për arsye se, sipas komunës këto obligime janë jashtë autoritetit dhe mundësisë për t'i planifikuar për shkak të kufizimeve që imponojnë qarkoret buxhetore të lëshuara nga MFPT për të respektuar kufijtë buxhetor. Ndërsa keq klasifikimet e shpenzimeve tjera ishin për shkak të keq buxhetimit të shkaktuar nga vet komuna.		janë edhe në sektorin e shëndetësisë. Kontrata kolektive për arsim e datës 21.01.2021 pasi është anuluar me 21.11.2022 nga MASHTI, nuk janë duke u bërë pagesa për paga jubilarë, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve, si dhe në përfundim janë pagesat e shujtave për stafin në arsim	
2	Pagesa për punë të pa-kryera	Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i pasurive/punëve pastaj duhet të bëhet	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive në procesin e menaxhimit të kontratave dhe të	Komuna do të ndërmarr të gjitha masat janë shtuar kontrollat dhe në teren ne realizimin e projekti si dhe	I zbatuar

		pagesa. Po ashtu edhe sipas kontratave, pagesat ekzekutohen për punët/pasuritë apo furnizimet e pranuar paraprakisht. Gjatë ekzaminimit fizik (të realizuar kah fundi i prillit 2023) të dy kontratave, kemi evidentuar pagesa për punë të cilat nuk ishin realizuar. Vlera e përbashkët e pagesave (të realizuara në dhjetor 2022) ishte prej 95,664€, përkatësisht: Te kontrata "Ndërtimi i stadionit të qytetit - faza e dytë" prej 1,750,491€, vlera e punëve të paguara por që nuk ishin realizuar është 68,268€. Përkatësisht fjala është për pozicionet 1.1, 4.2, 4.3, 4.4, 5.1, 5.2, 5.3 dhe 5.5 të paguara me situacionin nr. 18 në vlerë prej 100,000 ; si dhe Te kontrata "Fushat sportive dhe rekreacion LOT 2" prej 49,326 ,vlera e punëve të paguara por që nuk ishin realizuar është 27,396€. Projekti është për ndërtimin e dy fushave sportive, njëra në Tërstenik si dhe tjetra në Kizhnarekë. Pagesat për këtë kontratë pothuajse ishin kryer në tërësi, përkatësisht, vlera e paguar ishte 47,006€. Pozicionet e paguara që nuk ishin realizuar janë: V.4, V.5, V.6, dhe V.7 (pozicioni i V.7 ishte realizuar në fushën sportive në Kizhnarekë por jo edhe në Tërstenik). Menaxherët e kontratave na kanë siguruar dëshmi se punët kanë filluar	shpenzimit të parasë publike, për tu siguruar se raportet/situacionet për pagesë bëhen vetëm për punët e realizuara.	janë përfunduar të gjitha punimet në projekt.	
--	--	---	--	---	--

		të realizoheshin pas ekzaminimit fizik, ndonëse gjatë kohës sa ishim në ekzekutim të auditimit (deri me 28.04.2023) punët ende nuk ishin përfunduar. Megjithatë, komuna na ka siguruar dëshmi (me dt. 08.06.2023) se tashmë punët ishin realizuar sipas pagesave të kryera. Shkaku i pagesave për punë të pakryera ishte mos lejimi që mjetet buxhetore të shkonin në suficit.				
3 A2	Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme nga taksat në ushtrimin e veprimtarisë biznesore	Neni 13 i Rregullores komunale Nr. 12-400-16587 për taksat, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, ka përcaktuar taksën vjetore me të cilën ngarkohen bizneset për ushtrimin e veprimtarisë afariste/biznesore në territorin e Komunës së Gllogocit. Faturimet bëhen sipas kodeve të përcaktuara për disa veprimtari biznesore (duhet theksuar se jo të gjitha kodet e përcaktuara nga Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës - ARBK ishin të përfshira në rregulloren komunale). Nga analizimi i bazës së ngarkesave për vitin 2022, kemi evidentuar mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme prej 38,775€, përkatësisht: Në 13 raste bizneset ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë totale prej 10,160€, kodet e veprimtarive të të cilave nuk ishin të parapara në rregulloren komunale. Prej	Kryetari duhet të sigurojë se taksat për ushtrimin e veprimtarisë biznesore ngarkohet ndaj bizneseve sipas rregullores komunale e cila tashmë ishte në proces të plotësimit ndryshimit si dhe të siguroj se përdoren softuer/sisteme efikase dhe efektive për menaxhimin e të hyrave nga taksat në biznese. Po ashtu, komuna duhet të bëjë marrëveshje me bizneset lidhur me mjetet financiare të paguara pa bazë në rregulloren komunale (mjetet financiare duhet t'u kthehen apo kartela e tyre financiare të vendoset në parapagim pasi që me rregulloren e re parashihet të përfshihen të gjitha kodet e veprimtarive sipas ARBK-së).	Ka filluar zhvillimi i procedurave në Zyren e prokurimit për pasje me softuer të Ri. Kërkesa nga drejtorati është dërguar me datën 12.07.2023 me numër 43/2023. Ritenderim -16.11.2023, 21.11.2023 anulim i aktivitetit të prokurimit.	I zbatuar	Zhvillimi i procedurave të prokurimit

		tyre kishin paguar dy (2) biznese prej 1,180€ duke rezultuar me mbivlerësim prej 8,980€; - Në 17 raste bizneset ishin ngarkuar me taksa vjetore me vlerë totale prej 29,450€ sipas kodit jo adekuat të veprimtarisë, ndërsa ngarkesat e duhura bazuar në kodet e parapara me rregullore duhej të ishin prej 10,350 , prej tyre, tre (3) biznese kishin paguar prej 10,000 duke rezultuar me mbivlerësim prej 9,100€; si dhe - Në 51 raste ishin ngarkuar me taksa vjetore me vlerë prej 20,695€ bizneset e themeluara si Biznese Individuale (B.I.), Ndërmarrje Tregtare Prodhuese (NTP) dhe Ndërmarrje Shoqërore (NSH), mirëpo të njëjta: sipas nenit 13.3 të rregullores janë të lira nga pagesa e takses komunale deri në kohë të pacaktuar. Sipas zyrtarëve komunal kjo gjendje ishte për shkak të mangësive në rregulloren komunale si dhe gabimeve gjatë ngarkesave/faturimeve në softuerin e menaxhimit të të hyrave nga taksa në ushtrimin e veprimtarisë biznesore, ku ngarkesat/faturimet nuk		taksa tarifa dhe gjoba. Tanimë është bërë drafti final me nr.01-052/03-46355 me datë 13.09.2023. Me ligjshmerin e vendimit për ndryshimin e një pjese të nenit 13 të rregullores me nr.1644-1/2023 me 05.09.2023 ,kemi verifikuar rastet dhe kemi bërë ndryshimet e nevojshme .		Mangësit në programin aktual .
--	--	--	--	--	--	---------------------------------------

4	gjenroheshin direkt nga sistemi por ato duhet të bëhen manualisht. Ndërsa ngarkesat e bizneseve të liruar sipas nenit 13.3 ishte bërë bazuar në kodet e përcaktuara me rregullore. Duhet theksuar se komuna në raste të caktuara, kishte përfillur kërkesat e rregullores dhe kishte bërë korrigjimin e ngarkesave sipas rregullores komunale. Neni 61.21 i RrUOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ”. Po ashtu, interpretimi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) ka përcaktuar se ndryshimet e kontratave mund të aplikohen pa procedura të reja të prokurimit vetëm nëse vlera financiare e këtyre ndryshimeve nuk është me shumë se 10% e vlerës së kontratës. Kemi evidentuar tre raste në të cilat kishte pasur ndryshime në kontrata mbi 10% të vlerës totale të kontratave. Këto ndryshime kanë të bëjnë me sasi të realizuara në pozicione të caktuara të cilat ishin kryesisht ishin aprovuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari pa aplikimin e procedurave	Ndryshime mbi 10% të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve). Çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit, do të bëhet vetëm pas sigurimit se kjo është në pajtim të plotë me kërkesat ligjore në fuqi lidhur me ndryshimin e kontratave.	Lidhur me ndryshimet mbi 10% të vlerës së kontratave brenda pozicioneve të paramasave dhe parallogarive janë njoftuar të gjithë menaxheret e kontratave. Pra, është bërë zbatim i plotë i rekomandimit të auditorit dhe nuk ka përsëritje të rasteve të tilla.	I zbatuar	

				të prokurimit. Përkatesisht kjo dukuri është identifikuar në këto kontrata: • Te kontrata "Ndërtimi i stadionit të qytetit - faza e dytë" prej 1,750,491€, ndryshimet ishin në 22 pozicione me vlerë prej 233,237€ apo rreth 13% e vlerës së kontratës, duhet theksuar se, përveç mos aplikimit të procedurave të prokurimit, për shumicën e këtyre ndryshimeve në pozicione nuk na janë siguruar as dëshmitë e aprovimeve nga zyra e prokurimit dhe ZKA. • Te kontrata "Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit" prej 215,556€, kemi evidentuar se katër (4) pozicione nuk ishin realizuar, për të mundësuar rritjen e sasive në një pozicion tjetër prej 31,448€ apo rreth 14% të vlerës së kontratës. Çmimi për njësi i kontraktuar sasia e të cilit është rritur, ishte Gypa HDPE SN/8 Ø250 mm prej 16€ (pozicioni 5.1). Përderisa, në anën tjetër, çmimet e pozicioneve të cilat nuk janë realizuar ishin jo normalisht të ulëta dhe nuk ishin trajtuar si të tilla gjatë vlerësimit të		
--	--	--	--	--	--	--

	rregullta të punës	procedurën e prokurimit publik lidhur Marrëveshjet për shërbime të veçanta. Përkatësisht, neni 59.1 ndër të tjera definon "shërbimet konsulente"- të cilat nënkuptojnë një shërbim të një natyre intelektuale apo konsultative, që furnizohet nga një konsulent ekspert dhe i kualifikuar në njëfushë të caktuar apo profesion dhe përfshin shërbime ku aspektet intelektuale dhe kontributet mbizotërojnë dhe tejkalojnë aspektet tjera fizike të kontratës. Kemi evidentuar se komuna kishte angazhuar gjashtë (6) persona sipas marrëveshjeve për shërbimeve të veçanta përmes procedurave të prokurimit. Mirëpo, stafi i angazhuar ishin për punë dhe detyra të rregullta pune që duhet të kryhen nga stafi i rregullt i komunës. Vlera e kompensimit gjatë vitit 2022 për stafin e angazhuar në këtë formë ishte prej 10,226€. Sipas zyrtareve komunal kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së vendeve të lira për rekrutimin e stafit të rregullt (ku me rastin e krijimit të vendeve të lira, dy prej tyre ishin punësuar si staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit).	e stafit për shërbime të veçanta aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës.	mungesë të stafit kemi përdorur procedurën për shërbime të konsulence sipas LPP-së dhe RRUOPP-së për kontraktimin e një konsulentit (1).		
6	Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë	Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Zbrija për vendbanimin parësor, paraqet: "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax	Janë filluar të identifikohen dhe të përmisohen të gjitha e rastet së bashku me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, kontratist	Pjesërisht i zbatuar	Për shkak të kompleksitetit të procedurës


C2	vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaror këtë në Komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohej zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) ngavlera e vlerësuar e njësies së objektit”. Nga analiza e shënimeve në bazën e të dhënave të Protax-it kemi identifikuar 12 raste në të cilat zbritja prej 15,000€ për vendbanimin parësor ishte aplikuar dy herë te tatimpaguesit e njëjtë. Si rezultat, për arsye të nënfaturimit të hyrat janë më të vogla për 270€. Sipas zyrtarëve komunal kjo gjendje për shkak të bashkimit të tatimpaguesve të cilit ishin të ndarë por të cilit nuk ishin pranuar në sistemin Protax për arsye të çështjeve teknike	të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të komunës dhe me ligjin e tatimit në pronë.	Departamentin e Tatimit në Pronë- të cilët menaxhojnë komplet me regjistrat e tatimit në pronë, e specifikisht me sistemin Protax, i cili sistem është bërë i ri si platform, dhe nga bartja e të dhënave nga sistemi Protax i vjetër tek sistemi i ri Protax, janë rrjedhur lëshime të ndryshme, si fshirje e verifikimeve, modifikimeve, azhurimeve, fotove, si dhe janë lëshuar gabime në dy fishimin e lirimit nga banimi primar në më shumë se në një vend ashtu si edhe është paraparë me ligje. Në kushte normale të punës nuk ka mundësi që me ju caktu dy banime primare, sepse nuk lejon sistemi, automatikisht tregon se tatimpaguesi e ka të caktuar një banim primar. Ministria e Financave Departamenti i Tatimit në Pronë; ZTPR Drenas: Sadete Kllokoqi Fatbardhë Veliu	ve të modifikimit/korrigjimit të sistemit Protax i cili menaxhohet nga Ministria e Financave Departamenti i Tatimit në Pronë, ky korgjim ka filluar në muajin korrik 2023 dhe do të përfundon në muajin dhjetor 2024
----	--	--	--	---

7	- Mangësi në menaxhimin e pasurive	Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Po ashtu, neni 19.4.3 i kësaj rregulloreje përcakton se duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurive jo financiare. Kemi evidentuar se pagesat e kontratës "Furnizimi i shkolave me kabinetepër kimi, fizikë dhe biologji" prej 48,818€ janë regjistruar në sistemin E pasuria, përderisa kjo është dashur të bëhej në SIMFK sipas vlerës së furnizimeve për kabinetet përkatëse. Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Mangësitë në regjistrimin e pasurive si dhe procesin e inventarizimit, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit të pasurive.	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Komuna ka ndërmarr të gjitha masat dhe regjistrimi në SIMFK i kabineteve të shkollave është bërë me këto Id.99682,99683,99684,99--687,99689.	I zbatuar	
---	------------------------------------	--	--	---	-----------	--

B2

8	Mungesa e projekteve ekzekutuese	Neni 20 pika 10 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Nga 64 projekte kapitale në të cilat kishte shpenzim gjatë vitit 2022, kemi identifikuar se për 41 kontrata pune, Komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutuese sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e buxhetit për kontraktimin e një operatori për hartimin e projekteve ekzekutive.	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos inicohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Drejtoria e Infrastruktura Publike ka lidhur kontratë për hartim të projekteve. Kontraten me numër 611-23-6859-211 dhe 17.08.2023.	I zbatuar	
9	Menaxhimi jo efektiv i llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 16 të Rregullores MF- nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të	Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme përfshirë edhe ato ligjore, për të siguruar efikasitet më të lartë në	Sa i përket llogarive të arkëtueshme nga qeratat, Komuna-DBF ka marrë masa me vrejtje dhe ka përcjell të përmbaruesi privat. Borgji me i madh	Pjesërisht i zbatuar	
B3						
B4						

		mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Po ashtu, arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Krahësuar me vitin paraprak rritja totale e të arkëtueshmeve ishte rreth 424,273€ apo rreth 12%. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë, përkatësisht në vlerë 1,843,543€ apo rreth 49%, taksës në biznese 1,361,734€ rreth 36%, qiratë 527,520€ rreth 14% si dhe lejet ndërtimore 19,573 rreth 1%. Përkundër disa masave të ndërmarra, rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre.	arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	rrjedh nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë (për parkun e Biznesit në Korroticë të Eperme) me shumë prej: 474.351.39€. Ku për këtë shumë lëndet i kemi procedue në Gjykatën Komerciale, pasi MTI-ia nuk i ka kryer obligimet (të bashkangjitur keni padin në Gjykatën Komerciale). Ndersa pjesën tjetër të borgëve të qerave, ju kemi bërë vrejjet para së dergohen lëndet të përbaruesi privat. Një pjesë e borgjeve janë inkasuar për vitin 2022. (të bashkangjitur keni vrejjet dhe faturat) Per leje ndertimore komuna ka marr masa dhe ka inkasuar ne vlerne 1,110.84€ nga Bekim Morina, pjesa tjerer e investitorve janë ne procesin e legalizimit dhe do te inkasohen borxhet.	
--	--	--	---------------------------------------	--	--



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHA
GLLOGOC - DRENAS



NPL. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHA.
MPE. "BUS STATION" JS.
GJP. "ATUOBUSKA STANICA" AD.

Nr: 06/2024 Data: 22/02 Viti: 20 24
No: _____ Date: _____ Year: _____

GLLOGOC / DRENAS

NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA Drenas

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 neni 21, paragrafi 21.1 dhe mbështetur në Statutin e NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA. Nr. 02-030101-30488 të datës 24/06/2022, plotësim ndryshimi të dt. 07/08/2023 të Statutit, përkatësisht të nenit 19, pika 4 BoD i NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA në mbledhjen e mbajtur më 22/02/2024 mori këtë:

V E N D I M

Aprovimin e Planit të Biznesit 2024 të NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA - Drenas

- I. Bazuar në mbështetur në Statutin e NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA. Nr. 02-030101-30488 të datës 24/06/2022, plotësim ndryshimi të dt. 07/08/2023 të Statutit, përkatësisht të nenit 19, pika 4 BoD i NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA në mbledhjen e mbajtur më 22/02/2024 pas shqyrtimit, analizimit dhe rekomandimeve të dhëna të cilat u përfshin në Planit të Biznesit mori vendim unanim qe të miratoi Planin e Biznesit 2024 NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA Drenas.
- II. Planin e Biznesit 2024 NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA Drenas tani të aprovuar duhet të e zbatoi menaxhmenti i NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA Drenas dhe nese do ketë pengesa gjatë implementimit duhet të propozoi BoD qe në gjashtë mujorin ta bej revidimin.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

BoD i NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA – Drenas



Zymer Zekaj

Kryesues i BoD

Vendimi i dërgohet:

- Menaxhmentit NPL. NPL „Stacioni i Autobusëve” SHA Drenas
- Aksionarit të KK - Drenas
- Anëtarëve të BoD. të NPL-së
- Sekretarit të NPL-së
- Arkivit të NPL-së




Republika e Kosovës
Komuna e Glllogocit
Kuvendi i Komunës



NPL. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHA
MPE. "BUS STATION" JS.
GJP. "ATUOBUSKA STANICA" AD.

Nr: 07/2024 Data: 102/1 Viti: 20 24
No: Date: Year:
GLOGOC/DRENAS



NPL. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHA.
GJP. "AUTOBUSKA STANICA" AD.
MPE. "BUS STATION" JS.
GLOGOVCI - DRENAS

PLANI I BIZNESIT

DRENAS



PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	- 2 -
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	- 3 -
2. HISTORIA E NDËRMARRJES.....	- 4 -
3. VIZIONI.....	- 4 -
4. MISIONI	- 5 -
5. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024	- 5 -
5.1. Objektivi 1. Rritja e të hyrave.....	- 5 -
5.2. Objektivi 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në stacion....	- 6 -
5.3. Objektivi 3. Sigurimi i investimeve përmes donatorëve.....	- 6 -
5.4. Objektivi 4. Investimi në ngritjen e kapaciteteve të stafit.	- 6 -
6. PLANIFIKIMI I BUXHETIT FINANCIAR PËR VITIN 2024	- 7 -
6.1 Të hyrat.....	- 7 -
6.2 Shpenzimet — kategoritë e shpenzimeve.....	- 8 -
6.2.1 Shpenzimet për paga dhe mëditje.....	- 8 -
6.2.2 Shpenzimet operative	- 8 -
6.3 Shpenzimet administrative.....	- 9 -
6.4 Investimet	- 10 -
6.5 Bilanci i suksesit	- 10 -
7. SWOT ANALIZA E NDËRMARRJES.....	- 12 -
8. BURIMET NJERËZORE.....	- 13 -
8.1. Nevojat aktuale për personel	- 13 -
8.2. Programet e zhvillimit të personelit punues	- 13 -
8.3. Politika e kompensimit të stafit dhe matja e performancës	- 14 -
9. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	- 15 -
10. PLANI OPERATIV	- 16 -
10.1. Objektivat 1 Shtimi i të hyrave	- 17 -
10.2 Objektivat 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në stacion.	- 18 -
10.3 Objektivi 3. Sigurimi i investimeve	- 18 -
10.4 Objektivi 4 - Menaxhmenti	- 19 -
11. Struktura organizative e NPL “Stacioni i Autobusëve” në Drenas	- 20 -

JB

LISTA E SHKURTESAVE

NPL- Ndërmarrja Publike Lokale

SH.A – Shoqëri Aksionare

ARBK- Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

KK- Kuvendi Komunal

LPP- Ligji mbi Prokurimin Publik

DSA- Drenas Stacioni i Autobusëve

MI- Ministria e Infrastrukturës

OT-Operatorët Transportues

BERZh- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

RB

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2024, do të jetë viti më sfidues për ndërmarrjen duke qenë se është viti i parë që ndërmarrja operon si e plotë me bord, menaxhment dhe staf bazik, bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike si dhe Statutin e NPL 'Stacioni i Autobusëve'- Drenas.

Gjendja faktike e ndërmarrjes ndonëse me sfida të mëdha të cilat e rëndojnë gjendjen financiare të ndërmarrjes, siç janë të hyrat e ulëta në ndërmarrje si pasojë e kushteve jo të përshtatshme operuese të stacionit, procesi i licencimit të stacionit, mungesa e hapësirave të përshtatshme të punës, mungesa e teknologjisë adekuate për operim më efikas të ndërmarrjes, si dhe shpenzimet shumë të larta të trashëguara nga viti paraprak që kanë të bëjnë me mënyrën e gjenerimit të të ardhurave nga aktivitetet primare dhe sekondare të ndërmarrjes.

Menaxhmenti i ndërmarrjes, ka realizuar këtë plan të biznesit i cili në bazë të planifikimit parashihet të jetë me një bilanc pozitiv.

Qëllimi kryesor i ndërmarrjes gjatë vitit 2024 , do të jetë rritja e të hyrave e cila pritet të ndodhë si ndikim në ngritjen e ofrimit të cilësisë së shërbimeve, ngritjen e shkallës së inkasimit, e cila do të bëhet përmes rritjes së efikasitetit në punë si dhe rritjes së kontrollit të brendshëm.

Buxheti i ndërmarrjes parashihet të jetë 136,576.00€, ndërsa shpenzimet priten të jenë 134,410.08 €, ku Investimet paraqesin 49% të totalit, shpenzimet e pagave 38% dhe shpenzimet tjera 13% . Parashihet që në fund të vitit 2024 , ndërmarrja të jetë me një bilanc pozitiv prej 2,165.92 €.

Si qëllim kryesor i ndërmarrjes do të jetë vazhdimi i komunikimit kualitativ me palët me interes për ndërmarrjen duke vendosur një komunikim profesional me transportuesit, bizneset të cilët i shfrytëzojnë hapësirat e ndërmarrjes me qira si dhe me udhëtarët të cilët janë faktorë kryesor në arritjen e suksesit të ndërmarrjes.

Këtë vit menaxhmenti i ndërmarrjes ka planifikuar të investojë në ngritjen profesionale të shërbimeve me qëllim të rritjes së cilësisë dhe të arritjes së objektivave. Sa i përket investimeve kapitale për shkak të mungesës së fondeve investuese, është planifikuar që investimet kapitale të realizohen përmes zhvillimit të procedurave nga Komuna e Drenasit gjatë vitit 2024.

AB

2. HISTORIA E NDËRMARRJES

Ndërmarrja Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SHA, në Drenas me nr. unik 812094209, është themeluar në vitin 2023, me kapital themeltar në vlerë 10,000€.

Pas përfundimit të procedurave ligjore për regjistrim në ARBK dhe transformimit në ndërmarrje publike komunale, si shoqëri aksionare me Kuvendin Komunal (KK) të Drenasit, si pronar të vetëm të ligjshëm të të gjitha aksioneve të ndërmarrjes. Komuna e Drenasit ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e parapara me ligjet në fuqi, por edhe me Statut dhe akte të tjera nënligjore të ndërmarrjes.

Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të hyrave janë shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave për operatorët e transportit, shërbimi i parkingut, dhe aktivitetet tjera të cilat kanë të bëjnë me misionin bazë të ndërmarrjes.

3. VIZIONI

Të jetë pikë referuese për transport të komunikacionit të udhëtareve, të ofrojë shërbime efikase atraktive të qasshme, të pranueshme dhe me kushte të mira gjithmonë në drejtim të plotësimit të kërkesave të konsumatorëve dhe maksimizimit të profitit.

Vizioni i ndërmarrjes është që në vazhdimësi të ofrojë shërbime sa më cilësore për publikun dhe klientët, por edhe të ketë një qëndrueshmëri financiare, ngase këto dy elemente janë qenësore për zhvillimin dhe modernizimin e mëtutjeshëm të Stacionit të Autobusëve.

Si rrjedhojë, NPL Stacioni i Autobusëve SHA. Drenas planifikon të mbetet një qendër e rëndësishme e ofrimit të shërbimeve për klientët e vetë të shumtë, qoftë ata vendorë ose ndërkombëtarë.

Planifikimin dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim e modernizim e kemi nisur që tani, ndërkohë që brenda një të ardhme të afërt do të nisim edhe me implementimin e projekteve të shumta që synim kanë ofrimin e shërbimeve moderne shtesë, online, direkt, si dhe nëpërmjet marketingut në bazë të cilave “NPL Stacioni i Autobusëve Drenas” do të ketë rritje të vazhdueshme të hyrave, por edhe ngritje të imazhit të ndërmarrjes.

Natyrisht, për arritjen e gjithë këtyre objektivave në asnjë moment nuk do të anashkalohet bashkëpunimi me partnerë vendorë, e as me ata ndërkombëtarë. Investimet dhe zhvillimi i projekteve është vetëm një prej mundësive të shumta në këtë drejtim — natyrisht, gjithnjë duke u bazuar në ligjet dhe dispozitat ekzistuese ligjore.

AB

4. MISIONI

Mision i ndërmarrjes është të sigurojë një infrastrukturë të përshtatshme dhe shërbime të cilat e përmirësojnë përvojën e udhëtimit për qytetarët dhe ndikojnë në zhvillimin e qytetit dhe rajonit përreth duke ofruar shërbime cilësore dhe të përshtatshme për të plotësuar nevojat e udhëtarëve, duke përfshirë informacionin e saktë në lidhje me oraret e nisjes dhe arritjes së autobusëve, promovimin e përdorimit të transportit publik ofrimin e një transporti ekologjik dhe të qëndrueshëm, shërbime kualitative dhe të drejta për pasagjerët.

Bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe qendrore, si dhe me operatorët e transportit për të siguruar integritimin e përshtatshëm të stacionit të autobusëve në rrjetin e transportit publik dhe në planifikimin urban të qytetit.

Ndërmarrja, nëpërmjet ngritjes së cilësisë së shërbimeve, synon të rris të hyrat e saj duke krijuar kështu një ndërmarrje publike komunale me të hyra të qëndrueshme financiare.

5. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

Qëllim kryesor mbetet ngritja e shërbimeve të cilat pritet të rezultojnë në ngritjen e të hyrave të ndërmarrjes.

Qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes mbetet fokus thelbësor nga Menaxhmenti së bashku me punëtorët e ndërmarrjes. Arritja e këtyre qëllimeve planifikohet të bëhet përmes realizimit të objektivave të specifikuara si në vijim:

5.1. Objektivi 1. Rritja e të hyrave

Me këtë objektivë parashihet që deri në fund të vitit totali i të hyrave të jetë rreth 136,576.00 euro. Në realizimin e kësaj objektive kontribut i veçantë ka Aksionari (Kuvendi Komunal-Drenas me Drejtoritë përgjegjëse) Me mbikëqyrjen më rigoroze të mbajtjes së linjave të OT për Skenderaj dhe peronizimit të tyre në stacion, Stacioni i Autobusëve- Drenas do të kontribuonte jashtëzakonisht shumë në ofrimin e shërbimeve për udhëtarët të cilët dëshirojnë ta shfrytëzojnë stacionin si pikënisje si dhe do të rritet siguria e përgjithshme e transportit publik të udhëtarëve. Kontributi i Komunës së Drenasit do të ishte i jashtëzakonshëm në këtë drejtim me mundësimin që do ju kërkohet OT për Skenderaj të ndalej në Stacionin e Autobusëve në Drenas, me këto veprime të gjithë OT do të niseshin nga stacioni në kohën e duhur dhe duke respektuar orarin e vendosur nga Komuna e Drenasit

A.B

5.2. Objektivi 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në stacion

Menaxhmenti i ndërmarrjes do të fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve në stacion. Përmirësimi i shërbimeve do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e të hyrave të ndryshme duke filluar nga shërbimi i peronizimit, shitja e biletave, rritjen e të hyrave nga parkingu i veturave dhe autobusëve që pritet të funksionalizohet me përmirësimin e hapësirave të objektit të stacionit si dhe të krijojë të hyra më të larta. Planifikohet që deri në fund të vitit 2024, të ofrohen edhe shërbimet online.

5.3. Objektivi 3. Sigurimi i investimeve përmes donatorëve

Identifikimi i Burimeve të Financimit: Në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe institucionet relevante, ndërmarrja publike e stacionit të autobusëve duhet të identifikojë burimet e mundshme të financimit, përfshirë Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal (BERZh), fondet qeveritare dhe donacionet nga institucione dhe organizata të tjera. Ndërmarrja do ta bëjë të pamundurën që gjatë kësaj periudhe të arrijë sa më shumë investime nga institucionet relevante komunale apo nga ndonjë donator i mundshëm të cilët pritet të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve të cilat do të ketë ndikim direkt në stabilitetin financiar të ndërmarrjes.

5.4. Objektivi 4. Investimi në ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Planifikimi i Programit të Trajnimit: Bazuar në nevojat e identifikuar, do të hartohet një program i strukturuar i trajnimit për të përmirësuar kompetencat dhe aftësitë e stafit. Ky program do të përfshijë trajnime mbi sigurinë në punë, shërbimin ndaj klientit, menaxhimin e konfliktit, dhe teknologjinë e re. Ndërmarrjes i nevojitet një staf i ngritur profesionalisht dhe me kapacitete të larta në mënyre që të arrihet përmbushja e objektivave. Investimi në ngritjen e kapaciteteve të stafit të ndërmarrjes publike të stacionit të autobusëve në Drenas do të realizohet në një mënyrë të qëndrueshme dhe efektive, duke siguruar një ekip të përgatitur dhe të motivuar për të ofruar shërbime cilësore dhe për të përmirësuar përvojën e udhëtimit për udhëtarët.

A.B

6. PLANIFIKIMI I BUXHETIT FINANCIAR PËR VITIN 2024

N.P.L. Stacioni i Autobusëve" SHA. Drenas në vijim me shkurtesën -NPL DSA ka përgatitur planifikimin e buxhetit financiar për Vitin 2024, referuar aktiviteteve dinamike dhe përgatitjeve që ka zhvilluar gjatë vitit aktual 2023 për vazhdimin e zhvillimit progresiv për vitin 2024

-NPL DSA e fillon një vit të ri financiar pas një periudhe mjaft të vështirë si pasojë e procedurave ligjore fillestare si ndërmarrje e re, gjithashtu mënyra e inkasimit e cila kishte pasoja të konsiderueshme në afarizmin e ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2023 në bazë të analizave financiare kemi pas lëvizje të të hyrave. E nga viti 2024 me aplikimin e arkës fiskale vërehet inkasimi pozitiv dhe parashihet gjenerim me i rregullt i të hyrave kryesore të ndërmarrjes nga peronizimi

Më poshtë paraqiten planifikimet financiare buxhetore apo, vijat buxhetore për të hyrat dhe shpenzimet dhe investimet në forma të tabelave dhe me përshkrime sqaruese të llogaritjeve.

6.1 Të hyrat

NPL "Stacioni i Autobusëve", sh. a. Drenas (-NPL DSA) është ndërmarrje publike e cila i gjeneron të hyrat vetanake përmes shitjes së shërbimeve të ndryshme të cilat i ofron dhe ato janë: Shërbimi i Peronizimit dhe Shërbimi i Parkingut. Aktivitetin primar për krijimin e të hyrave e ka shërbimin e peronizimit, shërbim i ofruar për të gjithë operatorët e transportit rrugor të udhëtareve, të cilët në bazë të rendit të udhëtimit të ofruar nga Ministria e Infrastrukturës, Komuna e Drenasit e me të cilët -NPL DSA lidhë marrëveshjet kontraktuale për ofrimin e shërbimeve dhe për çmimet e peronizimit. Shitja dhe shërbimi i peronizimit paraqet të hyrat kryesore të cilat krijohen gjatë vitit nga ndërmarrja.

Aktivitet tjetër me rëndësi është shërbimi i parkingut për vetura të ndryshme. Çmimi i shërbimit strukturohet në bazë të madhësisë së automjetit si dhe kohës së qëndrimit në parking.

Po ashtu, janë evidente edhe të hyrat të cilat planifikohen të krijohen përmes marketingut respektivisht, promovimi i bizneseve të ndryshme përmes web faqes zyrtare të ndërmarrjes si dhe vendosja e ndryshme e panove reklamuese.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2024 janë përlllogaritur duke marrë për bazë të hyrat mesatare nga viti paraprak.

Tabela e mëposhtme paraqet planifikimin e të hyrave për vitin 2024.

Përshkrimi	Totali/Euro
Peronizimi	42,240.00
Parkingut	6,336.00
Të hyra nga marketingu	6,000.00
Donacion nga komuna	62,000.00
Nga aplikimi në organizata financuese (Grante)	20,000.00
Totali i të hyrave	136,576.00

A.B

6.2 Shpenzimet — kategoritë e shpenzimeve

Pjesa e mëposhtme paraqet kategoritë e shpenzimeve dhe vijat buxhetore për shpenzimet që do jenë të nevojshme për aktivitetet e punës gjatë vitit 2024. Shpenzimet janë vlerësuar dhe llogaritur në masën më të saktë të mundshme për vijat buxhetore që do të prekin aspektin financiar për të përmbushur operimin normal të punës, në ndërmarrje. Shpenzimet e përgjithshme janë të ndara në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje, shpenzimeve operative, shpenzimet administrative dhe shpenzime të dedikuara për investime të nevojshme të cilat janë të domosdoshme për operacionet e ndërmarrjes.

6.2.1 Shpenzimet për paga dhe mëditje

Në kuadër të shpenzimeve për paga dhe mëditje janë të ndara kategoritë e ndryshme, shpenzime për paga të anëtarëve të bordit të drejtorëve, pagat e zyrtareve të lartë (KE, ZAB, Sekretari, dhe ZKF&TH), pagat për punëtorët në operativë ku përfshihen punëtorët të cilët punojnë në sportele, laura, pastrim dhe sigurim.

Tabela në vijim paraqet të gjitha shpenzimet e specifikuar si me poshtë:

Bordi i drejtorëve (4 anëtarë të BD-së)	16,852.00
Zyrtarët e lartë (KE, sek, ZKF&TH, ZAB)	19,680.00
Operativa	16,128.00
Totali i shpenzimeve	52,660.00

6.2.2 Shpenzimet operative

Buxheti për shpenzime operative përfshin shpenzimet e nevojshme të cilat krijohen për operacionet e ndërmarrjes për operim sa më cilësor. Shpenzimet lidhur me energjinë elektrike mbesin ende të larta sepse energjia elektrike është burim kryesor për ngrohje, ndërsa sistemi i digjitalizimit është jetik për ndërmarrjen sepse të hyrat kryesore të ndërmarrjes menaxhohen përmes këtij sistemi.

Në tabelën më poshtë janë të prezantuar të gjitha shpenzimet e parashtruara nga Departamentet e -NPL DSA për operim më efikas.

Energjia elektrike	960
Ujësjiellësi dhe kanalizimi	240
Mbeturinat	360
Furnizim me material për mirëmbajtje të objektit	1,000.00
Furnizim me material higjienik sanitar	400.00
Furnizimi me material për zyre	400.00
Furnizimi me ujë të pijes	300.00
Shërbimi i dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim	300.00
Shërbimi i telefonisë mobile	120.00
Shërbimi i telefonisë fikse	120.00

AB

Shërbimi i internetit	240.00
Furnizimi me printer/skaner/fotokopje	500.00
Domani i webit	100.00
Hostimi i emailave	310.08
Shërbimi për software për menaxhim të kontabilitet financiar	1,300.00
Shërbimi i pastrimit	1,500.00
Shërbime të trajnimit	800.00
Shpenzime operative (ad hoc)	1,400.00
Totali i kostove	10,750.08

Vlera e shpenzimeve operative sipas tabelës më lartë është llogaritur, bazuar në shënimet e departamentit të operatives me personelin përgjegjës duke marrë për bazë çmimet e tregut nga furnizimet e mëparshme bazuar në hulumtimin e tregut për shërbime dhe materiale të ndryshme.

6.3 Shpenzimet administrative

Në kategorinë e shpenzimeve administrative, përfshihen shpenzime të ndryshme të cilat kane të bëjnë me angazhime të ndryshme të kompanive të pavarura, të cilat do të jenë të angazhuara për shërbime të ndryshme të listuara në tabelën e mëposhtme.

Vlerësimi për kënaqësinë e konsumatorit	1,200.00
Këshilla Ligjore dhe përfaqësim	1,000.00
Auditimi i jashtëm	2,000.00
Shpenzimet e reprezentacionit të KE-së	1,200.00
Shpenzime administrative të ad- hoc	1,000.00
Totali i kostove administrative	6,400.00

A.B

6.4 Investimet

Në këtë kategori janë të planifikuara investimet të cilat janë esenciale për nevojat operuese të ndërmarrjes. Të dhënat janë të paraqitura në tabelë. Investimi më i lartë ka të bëjë me ndriçim të brendshëm dhe të jashtëm në ndërmarrje me drita eficiente të cilat do të kenë ndikim përveç në krijimin e një ambienti më të mirë po ashtu, do të kenë ndikim në uljen e shpenzimeve operacioneve të ndërmarrjes

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura investimet e planifikuara të -NPL DSA-së:

Rregullimi i zyrave	22,000.00
Rregullimi i tualeteve	5,000.00
Furnizim me dritat e brendshme led për holle	500
Furnizim me ndriçim të jashtëm	1,000.00
Furnizim me mjete të TI-së	2,000.00
Furnizim me pajisje për vëzhgim (kamera, DVR, HDD)	500
Rrethoja e stacionit	12,000.00
Investim në digjitalizim të sistemit të faturimit dhe laurave	23,600.00
Totali i investimeve	64,600.00

6.5 Bilanci i suksesit

Sipas parashikimeve të hyrave dhe shpenzimeve, në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur bilancin e suksesit të planifikuar për periudhën e realizimit për Vitin 2024. Gjatë vitit të kaluar ndërmarrja ka pas një bilanc pozitiv në pjesën operative, pas rregullimit të procedurave ligjore dhe zyrtarizimit të ndërmarrjes. Për vitin 2024, është paraparë që me realizimin e projekteve të planifikuara për digjitalizim të proceseve të mbulohen shpenzimet administrative si dhe të gjenerojë të ardhura pozitive që të përmbyllë një sukses financiar.

Pas paraqitjes së shënimeve financiare për të hyrat dhe shpenzimet (të dalat), më poshtë paraqitet bilanci financiar i llogaritjes së të hyrave minus të dalat për të pasqyruar gjendjen financiare në fund të vitit 2024 (Fitim apo Humbje).

Të Hyrat totale	136,576.00
Kostot totale	134,410.08
Të hyrat – kostot	2,165.92

Bazuar në shënimet nga të hyrat dhe shpenzimet, bilanci financiar si në tabelën e mësipërme tregon për një rezultat pozitiv me fitim në fund të vitit 2024 në vlerë prej 2,165.92 euro.

Ky rezultat tregon se nga pjesa e të hyrave Menaxhmenti ka bërë planifikimet e shpenzimeve në kuadër të disponueshmërisë së mjeteve nga të hyrat, duke bërë

A.B.

shpërndarje të nevojshme të mjeteve ashtu që ndërmarrja të veprojnë në mënyrë efektive pa krijuar vështirësi në operimin e saj.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024, do të rishikohet dhe pas gjashtëmuajorit të parë, bazuar në ligjin nr. 04/L-111 neni 17.

A.B

7. SWOT ANALIZA E NDËRMARRJES

Analiza SWOT synon të identifikojë faktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm që shihen si të rëndësishëm për arritjen e objektivave të synuara të ndërmarrjes.

Analiza SWOT përgjithëson informacionet kryesore në dy kategori kryesore:

- Faktorët e brendshëm - pikat e forta dhe të dobëta të brendshme për organizatën
- Faktorët e jashtëm - mundësitë dhe kërcënimet e paraqitura nga mjedisi i jashtëm për organizatën

Duke analizuar SWOT analizën është e qartë që faktorë të brendshëm të zhvillimit të ndërmarrjes janë përparësitë dhe dobësitë. Ndaj këtyre faktorëve, ndërmarrja përmes operacioneve mund të ketë ndikim direkt në ndryshimin e tyre, ndërsa dobësitë dhe rreziqet janë faktorë të jashtëm të cilët mund të ndikojnë në afarizmin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

PËRPARËSITË	DOBËSITË
• Pozicioni Gjeografik i Favorshëm: Lokacioni i stacionit të autobusëve në Drenas është strategjik, duke qenë një pikë qendrore për transportin publik në rajonin përreth. • Ndërmarrje e Re: N.P.L Stacioni i Autobusëve - Drenas si ndërmarrje e re ka përparësi në përvetësimin e granteve fillestare dhe lehtësirat e tjera ekonomike të ndryshme të në përmirësimin e vazhdueshëm në infrastrukturën. • Bashkëpunimi me Autoritetet Lokale: Ndërmarrja publike ka një marrëdhënie të ngushtë me autoritetet lokale, duke ofruar mundësi për zhvillim të bashkëpunimeve të mëtejshme dhe përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta.	• Mungesa e Financimit të Mjaftueshëm: N.P.L - NPL DSA mund të përjetojë sfida në sigurimin e financimit të mjaftueshëm për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve. • Mungesa e Përdorimit të Teknologjisë së Avancuar: Nevoja për përdorim më të avancuar të teknologjisë për të përmirësuar përvojën e udhëtimit për udhëtarët. • Mungesa e stafit profesional • Mungesa e kapaciteteve për zhvillim dhe trajnim • Mungesë e infrastrukturës së unifikuar për kontrollin e të gjitha shërbimeve • Kufizimet e Infrastrukturës Ekzistuese: Ka kufizime në lidhje me hapësirën dhe kapacitetin për të përmbushur rritjen e kërkesës për transport publik.
MUNDËSITË	RREZIQET
• Financimi nga Burime të Jashtme: Mundësia për të siguruar financim nga burime të jashtme, siç janë grante dhe donacione nga organizata dhe institucione ndërkombëtare, mund të hapë rrugën për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve. • Potencial për zhvillim të veprimtarisë së marketingut • Rritja e Kërkesës për Transport Publik: Rritja e kërkesës për transport publik në rajonin përreth mund të sjellë mundësi për ndërmarrjen publike për të zgjeruar shërbimet dhe për të rritur numrin e udhëtarëve. • Inovacioni Teknologjik: Përdorimi i teknologjisë së avancuar për të ofruar shërbime më efikase dhe të përshtatshme për udhëtarët mund të sjellë avantazhe konkurruese për ndërmarrjen publike. • Bashkëpunimi me Sektorin Privat: Mundësia për të zhvilluar partneritete dhe bashkëpunime me kompanitë e transportit privat mund të sjellë përfitime të përbashkëta dhe zgjidhje inovative për zhvillimin e transportit publik.	• Ndryshimet Politike dhe Ligjore: Ndryshimet në politikat dhe rregullat ligjore në nivel qeveritar ose lokal mund të ndikojnë në operacionet dhe financimin e ndërmarrjes publike. • Pengesë nga operatorët e pa licencuar • Ndryshimet Ekonomike: Ndryshimet në situatën ekonomike, si rënia e të ardhurave personale të qytetarëve, mund të ndikojnë në kërkesën për transport publik dhe në të ardhurat e ndërmarrjes publike. • Teknologjia dhe Zhvillimi i Shoqërisë: Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe preferencat e ndryshme të përdoruesve për mënyrat e transportit mund të sjellë sfida për ndërmarrjen publike si dhe adaptimin e punonjësve aktual me teknologjitë e avancuara.

AB

8. BURIMET NJERËZORE

NPL "Stacioni i Autobusëve", SH. A., ka filluar punën në vitin 2023 me 4 të punësuar me kontrata me kohë të caktuar. Prej tyre 4 janë meshkuj dhe 3 femra. Moshë mesatare e punonjësve është 50 vjet. Tabela e mëposhtme paraqet ngritjen profesionale të punëtorëve të ndërmarrjes:

8.1. Nevojat aktuale për personel

Kualifikimi	
Master	2
Fakulteti	1
Shkollë e mesme	4
Punëtorë të kualifikuar (aftësim profesional)	0
Totali i punëtorëve	7

Me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara në këtë plan të biznesit, si dhe për qëllim të mbarëvajtjes së procesit të punës së NPL "Stacioni i Autobusëve", SHA. nevojitet të bëhet një ristrukturim i vendeve të punës si dhe nivelimi i pagave, në të ardhmen e afërt kur të krijohen kushtet e nevojshme për këtë veprim.

Për shkak të numrit të ulët të punëtorëve në ndërmarrje dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë nga punëtorët ekzistues pozitë e punës të cilat duhet të shpallen janë të shumta, por kjo varet nga niveli i performancës në ndërmarrje.

Shërbimi i pastrimit gjatë vitit 2024 , do të bëhet me kontratë për pastrim me kompani të jashtme të angazhuar gjatë vitit.

Vendet e lira të cilat mbesin të shpallen janë të planifikuara me strukturën organizative apo skemën funksionale e cila përputhet me strategjinë zhvillimore të ndërmarrjes. Struktura organizative ekzistuese e ndërmarrjes do të projektohet sipas rregullores si dhe burimeve financiare përgjatë vitit 2024.

8.2. Programet e zhvillimit të personelit punues

Programet duhet të përshtaten me nevojat specifike të personelit dhe të ndërmarrjes, duke përfshirë vlerësimin e nevojave dhe qëllimet e zhvillimit të personelit.

Trajnim për Sigurinë në Punë: Për punonjës të punojnë në operacionet e stacionit të autobusëve, trajnimi për sigurinë në punë është thelbësor. Këto trajnime mund të përfshijnë procedurat e sigurisë për udhëtarët dhe personelin, menaxhimin e emergjencave, si dhe mbrojtjen nga rreziqet e mundshme në ambientin e punës.

Trajnim për Shërbimin ndaj Klientit: Për të përmirësuar përvojën e udhëtimit për udhëtarët, punonjës të trajnohen për të ofruar një shërbim të lartë ndaj klientit. Kjo përfshin trajnime mbi komunikimin efektiv, zgjidhjen e konflikteve dhe menaxhimin e situatave të vështira me udhëtarët.

Trajnim për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit: Për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar shërbimet dhe komunikimin me udhëtarët, punonjësit mund të trajnohen për përdorimin e sistemeve të rezervimeve online, aplikacioneve mobile dhe teknologjisë së informacionit për të siguruar informacionin e nevojshëm për udhëtarët.

Rëndësi të veçantë do i kushtohet edhe licencimit të punëtorëve të cilët mbajnë pozita të cilat janë të obliguar të kenë certifikime të obliguara nga institucionet përkatëse p.sh. pozitat e zyrtarit për mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë në punë, zyrtarit certifikues të dokumenteve financiare, bashkëpunëtori në zyrën e prokurimit, ndërsa punëtorët e tjerë të cilët janë të licencuar janë të obliguar të ndjekin trajnime për vazhdimin e licencës së punës.

Matja e rezultateve të punës së punëtorëve do të bëhet në bazë vjetore, në fund të vitit kalendarik. Në bazë të këtyre vlerësimeve do të bëhet edhe evidentimi për trajnime shtesë të stafit të ndërmarrjes.

8.3. Politika e kompensimit të stafit dhe matja e performancës

Kompensimi i stafit do të bëhet bazuar në rregulloren e brendshme, niveli i edukimit dhe eksperiencia e punës.

A.B

9. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Transferimi i informacionit, krijimi i besimit me partnerët e ndryshëm të cilët i shfrytëzojnë shërbimet e ndërmarrjes është çështje thelbësore për një komunikim të qëndrueshëm dhe efektiv me publikun.

Përmes krijimit të një komunikimi të hapur dhe transparent është e mundur të arrihet një mirëkuptim me palët e interesit.

Zyra për marrëdhënie me publikun përmes një plani të hartuar do të përdor kanale të ndryshme të mediave dhe mjeteve të tjera në mënyrë direkte dhe indirekte për të krijuar dhe ruajtur një imazh pozitiv të ndërmarrjes, duke krijuar marrëdhënie të forta me audiencën e synuar përmes aktiviteteve të ndryshme, si dhe përmes nxitjes së marketingut dhe shitjes.

Zyra për marrëdhënie me publikun do të krijoj përmbajtje të ndryshme për në ueb faqen zyrtare të ndërmarrjes, blogje dhe programe TV. I gjithë aktiviteti do të përqendrohet në përdorimin e kanaleve të ndryshme të mediave me pagesë minimale.

Krahas komunikimit të jashtëm rëndësi të veçantë duhet kushtuar edhe komunikimit të brendshëm, kjo me qëllim të koordinimit të informatave me stafit. E veçanta e komunikimit të brendshëm është nisur nga fakti që në situatë krizash ose pandemish qarkullojnë informatat e shumta brenda kompanisë dhe është mëse e nevojshme që informatat të jenë nën kontroll me kohë dhe të sakta.

Në vitin 2024 planifikohet së bashku me organet komunale vendosja e një pike informuese turistike ku udhëtarët, turistët e ndryshëm, do të jenë në gjendje të marrin informacione të duhura dhe të nevojshme për qytetin dhe mënyrat e transportit në Komunën e Drenasit

A.B

10. PLANI OPERATIV

- **Zhvillimi i infrastrukturës:**
Identifikimi i nevojave për përmirësimin e infrastrukturës së stacionit të autobusëve.
Hartimi i planit për ndërtimin e vendeve shtesë të pritjes, banjove të përmirësuara dhe zona të tjera të shërbimit për udhëtarët.
Koordinimi me autoritetet lokale dhe agjencitë e ndërlidhura për sigurimin e financimit dhe lejeve të nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës.
- **Përmirësimi i shërbimeve për udhëtarët:**
Zbatim i sistemeve të informacionit të përditësuara për të siguruar informacionin e nevojshëm për oraret e autobusëve dhe shërbimet tjera të ofruara në stacion.
Përdorimi i teknologjisë për të lehtësuar biletat elektronike dhe rezervimet online për udhëtarët.
Hartimi i një plani për përmirësimin e shërbimeve të pritjes dhe të sigurimit për udhëtarët.
- **Përmirësimi i menaxhimit të operacioneve:**
Zbatim i procedurave të përdorura për menaxhimin e flukut të trafikut të autobusëve në stacion.
Trajnim i stafit për procedurat e sigurisë në punë, menaxhimin e konflikteve dhe shërbimin ndaj klientit.
Përdorimi i teknologjisë për monitorimin dhe përmirësimin e efikasitetit të operacioneve, duke përfshirë monitorimin e kohës së pritjes dhe kohës së udhëtimit të autobusëve.
- **Bashkëpunimi dhe lidhjet me partnerët:**
Krijimi i partneriteteve me operatorët e transportit për të siguruar integrimin e përshtatshëm të stacionit të autobusëve në rrjetin e transportit publik.
Bashkëpunimi me autoritetet lokale për të koordinuar zhvillimin urban dhe transportin lokal në Drenas.
- **Monitorimi dhe vlerësimi i performancës:**
Vendosja e një sistemi të vazhdueshëm monitorimi për të vlerësuar performancën e ndërmarrjes në përmbushjen e qëllimeve të saj.
Analiza e rezultateve për të identifikuar zonat e fuqisë dhe ato që kërkojnë përmirësime të mëtejshme.
- **Kujdesi për mjedisin dhe qytetin:**
Implementimi i iniciativave për të zvogëluar ndikimin mjedisor të operacioneve të ndërmarrjes publike, përfshirë reduktimin e gazrave të tymit dhe rritjen e përdorimit të mjeteve të transportit të qëndrueshëm.
Plani i veprimit gjithashtu do të trajtojë edhe objektivat jo financiare si ngritja profesionale dhe mirëqenien kolektive të stafit të ndërmarrjes.

X.B

10.1. Objektivat 1 Shtimi i të hyrave

Pasi që ndërmarrja operon në një situatë financiare jo të mirë, ku shpenzimet operative janë në një masë shumë të madhe në krahasim me të hyrat, objektivi kryesor për ndërmarrjen edhe gjatë vitit 2024, do të jetë dyfishimi i të hyrave.

NPL Stacioni i Autobusëve realizon të hyra vetanake nga shërbimet të cilat i ofron dhe të cilat janë të parapara me statut të ndërmarrjes. Këto shërbime janë si në vijim:

1. Transporti rrugor urban dhe ndër urban i pasagjerëve
2. Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit
3. Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve
4. Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor
5. Aktivitetet e agjencive të udhëtimit
6. Aktivitetet e operatorëve turistikë
7. Shërbimet e tjera të rezervimit dhe aktivitetet e lidhura me to

Objektivi i synuar pritet të arrihet përmes, pikave të mëposhtme:

Analizimi i potencialeve për rritje të hyrave, planifikohet identifikimi i potencialeve lidhur me rritjen e të hyrave duke filluar prej të hyrave nga peronizimi, parkingu, rritja e të hyrave nga marketingu dhe përmirësimi i shërbimeve.

Me nivelizimit të çmimit për shërbimin e peronizimit do të avancohen edhe më tej shërbimet për këtë kategori. Po ashtu gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit do të bëhet angazhim i shtuar i menaxhmentit dhe stafit në mënyrë që shërbimet të ofrohen në formën profesionale për linjat sezonale, si dhe të gjithë operatorët të cilët nuk e shfrytëzojnë ndërmarrjen për nisje të tyre këtë ta realizojnë sipas rendit të udhëtimit të cilin e lëshon MI.

-NPL DSA e konsideron të rëndësishë strategjike për zhvillim ofrimin e aktivitetit të shitjes së biletave për kompanitë e udhëtimit. Menaxhmenti i -NPL DSA planifikon të takohet me transportuesit në përpjekje për arritje të marrëveshjes. Për këtë çështje ndihmë të çmueshme mund të ofrojnë - MI Inspektorët e komunikacionit, KK Drenas Inspektorët e komunikacionit, ATK Inspektorët Tatimor dhe Policia e Kosovës. Këto veprime do të ishin edhe në funksion të luftimit të evazionit fiskal. Në TM III-të të vitit Menaxhmenti i -NPL DSA do të bëjë përpjekje për arritjen e marrëveshjes me bankat komerciale për funksionalizimin e shërbimeve për shitjen online të biletave.

Ofrimi i shërbimeve të parkingut, ndërmarrja posedon infrastrukturë për parkimin e automjeteve. Në funksion të rritjes së të hyrave financiare duhet të rriten kapacitetet ekzistuese të hapësirës së parkimit për automjete me theks të veçantë në ri funksionalizimin e pjesës së parkingut për autobus , si dhe zgjerimin e kapacitetit ekzistues të parkingjeve për vetura të vogla. Zgjerimi i hapësirave të parkingut për autobus dhe vetura konsiderohet si e domosdoshme në mënyrë që të rriten të hyrat e ndërmarrjes.

Të planifikohen investime të domosdoshme që kanë të bëjnë në përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve publike. Gjatë vitit do të bëhen përpjekje maksimale që të funksionalizohet laura digjitale si dhe shërbimet të tarifohen në mënyrë më efektive. Hapësirat e objektit të stacionit të autobusëve pas verifikimit të pronësisë, të lëshohen me qira për kompanitë e transportit.

Ofrimi i shërbimit të ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, është shërbimi i radhës që planifikohet nga -NPL DSA, mirëpo ky shërbim do ofrohej nëse do realizohej investimi në objektin e stacionit, me të cilin do të realizohet një rritje e lehtë e të hyrave duke u bazuar në kohëzgjatjen e bagazhit i cili do të ruhej nga shërbimi i ofruar në ndërmarrje.

X.B

10.2 Objektivat 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në stacion.

Deri në fund të vitit 2024 pritet të ofrohen edhe shërbimet online, pritet që të realizohet inkasimi digjital përmes laurës digjitale si dhe të ofrohen shërbimet e marketingut përmes tablove reklamuese. Në çdo aktivitet i cili lidhet me arritjen e objektivit të parë, do të realizohen aktivitetet të veçanta që të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme të gjitha shërbimet e ofruara të ndërmarrjes. Të gjitha këto aktivitete pritet që të kenë ndikim gjatë tërë vitit kalendarik.

Qëllim kryesor i lidhur me objektivin e dytë do të jete që të gjitha shërbimet e ndërmarrjes të fillojnë të ofrohen online deri në fund të vitit.

10.3 Objektivi 3. Sigurimi i investimeve

Investimet kapitale janë çështje zhvillimore për çdo ndërmarrje

Identifikimi i Nevojave të Investimeve: Në bashkëpunim me menaxhmentin e ndërmarrjes dhe autoritetet lokale, do të bëhet një vlerësim i hollësishëm i nevojave për investime në stacionin e autobusëve. Kjo përfshin identifikimin e infrastrukturës së nevojshme, si dhe përmirësimet e shërbimeve dhe operacioneve.

- Hartimi i Projekteve të Financimit: Bazuar në nevojat e identifikuara, do të hartohen projekte të detajuara të cilat do të përshkruajnë qëllimet, kostot dhe përfitimet e investimeve të propozuara. Këto projekte do të përfshijnë infrastrukturën fizike, teknologjinë dhe përmirësimet e shërbimeve.
- Kërkesa për Financim: Pas hartimit të projekteve të financimit, do të paraqiten kërkesat për financim të burimet e mundshme, përfshirë autoritetet lokale, donatorët e potencial, dhe agjencitë e financimit qeveritar ose ndërkombëtar.
- Lobimi dhe Prezantimi i Projekteve: Do të zhvillohet një fushatë e lobimit dhe prezantimit për të siguruar mbështetje për projektet e financimit. Kjo përfshin takime me donatorët potencialë, prezantime publike dhe lobim në nivel lokal dhe qendror.
- Aplikimi dhe Kryerja e Projekteve: Pas marrjes së financimit, projekteve do t'u jepet fillimi. Kjo përfshin ndërtimin, implementimin dhe monitorimin e tyre për të siguruar që të përmbushen qëllimet e përcaktuara dhe për të përcaktuar ndonjë ndryshim të nevojshëm në rrjedhën e punës.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Performancës: Pas kryerjes së projekteve, do të kryhet një monitorim dhe vlerësim i performancës për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e investimeve. Kjo përfshin vlerësimin e përmbushjes së qëllimeve të projektit dhe efektet e tyre në përmirësimin e shërbimeve dhe operacioneve të stacionit të autobusëve.

AB

10 .4 Objektivi 4 - Menaxhmenti

Qëllimi kryesor i menaxhmentit do të jetë të funksionon sipas ligjeve në fuqi përmes përditësimit të vazhdueshëm të rregulloreve të brendshme, përpilimin e kontratave të ndryshme lidhur me shërbimet dhe monitorimin e tyre, si dhe rendësi të veçantë do ju kushtohet rregullimit të sistematizimit të rregulloreve. Po ashtu, theks i veçantë do ju kushtohet krijimit të hyrave të qëndrueshme të ndërmarrjes duke aplikuar standardet bashkëkohorë të financave dhe të kontabilitetit.

Shërbimi teknik do i kushtojë rendësi të veçantë në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për auto transportuesit.

Themelimi i zyrës për prokurim e cila do të planifikojë të gjitha furnizimet e nevojshme në bazë të LPP-së.

Formimi i zyrës për burime njerëzore që do të jete vigjilente që të gjitha sistemimet dhe procedurat të jenë sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Departamenti i operativës do të sigurojë që të gjitha sistemet të jenë në funksion, pra sistemi i laurave të jetë funksional dhe sistemet tjerat të ndërlidhura të jene funksionale. duke përfshirë edhe sistemin e monitorimit — vëzhgimit me kamera.

Shërbimi i sigurimit fizik, përveç që do të jetë përgjegjës për sigurimin e aseteve të ndërmarrjes, si përgjegjës i sektorit të laurave, përmes menaxhimit të suksesshëm dhe monitorimit të vazhdueshëm, do të mundësojë që të gjitha daljet të regjistrohen dhe të bëhet inkasimi i rregullt. Në këtë mënyrë pritët që të hyrat e ndërmarrjes të rriten në mënyrë konstante.


Zyra për marrëdhënie me publikun duke përdorur kanale të ndryshme të mediave dhe mjeteve të tjera në mënyre direkte dhe indirekte për të krijuar dhe ruajtur një imazh pozitiv të ndërmarrjes dhe duke krijuar një marrëdhënie të qëndrueshme me audiencën e synuar në lidhje me marketingun e ndërmarrjes.

Shëndeti në punë dhe mbrojtja e punëtoreve është një nga objektivat kryesore të menaxhmentit. Përmes zyrtarit përgjegjës do të merren të gjitha masat që punëtorët e ndërmarrjes të punojnë në një ambient të mirë të punës dhe të kenë një mbrojtje të vazhdueshme nga faktorët e jashtëm.

A.B

11. Struktura organizative e NPL "Stacioni i Autobusëve" në Drenas

STACIONI I AUTOBUSAVE SH.A. NË DRENAS



AB